



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 593, datë 26.11.2020

PËR
MIRATIMIN E FONDEVE TË LIRA, NGA BUXHETI I VITIT 2020, NË SISTEMIN
GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave, kërkesës së Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë si dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në sistemin gjyqësor, si mëposhtë;
 - në programin 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i KLGJ-së, për shumën prej 11 000 000 (njëmbëdhjetë milion) lekë, sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur.
 - në programin 03310, “Buxheti gjyqësor” buxheti i Gjykatave, për shumën prej 153 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e tre milion) lekë, sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur.
2. Fondet e lira të miratuara, t’i konfirmohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të rishikimit të Buxhetit të Shtetit.
3. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Pasqyra nr. 1

Pasqyra e fondeve të lira të miratuara, nga programi 01110, buxheti i KLGJ-së.

000/lek

<i>Kodi i institucionit</i>	<i>Emërtimi i programit</i>	<i>Programi buxhetor</i>	<i>Llogaria ekonomike</i>	<i>Shuma e fondit për pakësim</i>	<i>Emërtimi i shpenzimit</i>
1029001	Planifikim, Menaxhim, Administrim	01110	600 601	5 000 6 000	Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore personeli
1029001	Planifikim, Menaxhim, Administrim	01110	602	-	Shpenzime për mallra dhe shërbime
1029001	Planifikim, Menaxhim, Administrim	01110	231	-	Shpenzime për investime
	Totali			11 000	

Pasqyra nr. 2

Pasqyra e fondeve të lira të miratuara, nga programi 03310, buxheti i Gjykatave.

000/lek

<i>Kodi i institucionit</i>	<i>Emërtimi i programit</i>	<i>Programi buxhetor</i>	<i>Llogaria ekonomike</i>	<i>Shuma e fondit për pakësim</i>	<i>Emërtimi i shpenzimit</i>
1029001	Buxheti i Gjykatave	03310	600 601	135 000 6 000	Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore personeli
1029001	Buxheti i Gjykatave	03310	602	12 000	Shpenzime për mallra dhe shërbime
1029001	Buxheti i Gjykatave	03310	231	0	Shpenzime për investime
	Totali			153 000	